



**KËSHILLI I
BASHKIMIT EVROPIAN**

**Bruksel, 12 shkurt 2008
(OR. en)**

**5576/1/08
REV 1**

**COWEB 27
COSDP 61
PESC 88
RELEX 38**

AKTET DHE INSTRUMENTAT E TJERA LEGJISLATIVE

Lënda: **VENDIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT për emërimin e Përfaqësuesit
Special të Bashkimit Evropian në Kosovë**

VENDIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT 2008/.../CFSP

për

emërimin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian
në Kosovë

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke respektuar Traktatin e Bashkimit Evropian dhe, në veçanti Nenet 14, 18(5) dhe 23(2) të saj,

Duke pasur parasysh se:

- (1) Më 10 qershor 1999 Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1244.
- (2) Më 15 shtator 2006, Këshilli miratoi Vendimin e Përbashkët 2006/623/CFSP¹ mbi krijimin e një ekipi për të kontribuar në përgatitjet për themelimin e Zyrës së mundshme Ndërkombëtare Civile në Kosovë, duke përfshirë komponentin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (Ekipi Përgatitor i ICO/EUSR).
- (3) Më 13/14 dhjetor 2007, Këshilli Evropian nënvizoi se BE-ja qëndron e gatshme për të luajtur një rol drejtues në forcimin e stabilitetit në rajon dhe në implementimin e marrëveshjes që përcakton statusin e ardhshëm të Kosovës. Ai theksoi gatishmërinë e BE-së për të ndihmuar Kosovën në rrugën drejt stabilitetit të qëndrueshëm, duke përfshirë misionin ESDP dhe kontributin për zyrën ndërkombëtare civile si pjesë e pranive ndërkombëtare.
- (4) Paralelisht me këtë Vendim të Përbashkët, Këshilli do të miratojnë një Vendim të Përbashkët mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX KOSOVO).
- (5) Procesi i Stabilizim Asocimit është korniza strategjike për politikën e BE-së për rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe instrumentet e tij aplikohen për Kosovën, duke përfshirë partneritetin evropian, dialogun politik dhe teknik sipas Mekanizmit Përcjellës së Procesit të Stabilizim Asocimit, dhe programet e asistencës të Komunitetit që janë të lidhura me të.
- (6) Mandati i EUSR duhet të implementohet në koordinim me Komisionin, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me aktivitetet e tjera relevante që bien nën kompetencat e Komisionit.
- (7) Këshilli parashikon që kompetencat dhe autoriteti i EUSR dhe kompetencat dhe autoriteti i Përfaqësuesit Ndërkombëtar Civil do t'i jepen të njëjtit person.

¹ OJ L 253, 16.9.2006, fq. 29. Vendimi i Përbashkët i amenduar dhe zgjatur së fundmi nga Vendimi i Përbashkët 2007/744/CFSP, OJ L 301, 20.11.2007 fq. 27.

- (8) EUSR do ta implementojë mandatin e tij në kontekstin e një situatë që mund të përkeqësohet dhe mund të dëmtojë objektivat e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë siç përcaktohet në Nenin 11 të Traktatit.

KA MITATUAR KËTË VENDIM TË PËRBASHKËT:

Neni 1
Emërimi

Z. Pieter Feith emërohet si Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (EUSR) në Kosovë për periudhën nga data e miratimit të Vendimit të Përbashkët deri më 28 Shkurt 2009.

Neni 2
Objektivat e Politikës

Mandati i EUSR do të bazohet në objektivat e politikës së BE-së në Kosovë. Këto përfshijnë luajtjen e një roli drejtues në forcimin e stabilitetit në rajon dhe në implementimin e marrëveshjes që përcakton Statusin e ardhshëm të Kosovës, me qëllim krijimin e një Kosove stabile, të qëndrueshme, paqësore, demokratike dhe shumë-etnike, që kontribuon në bashkëpunimin dhe stabilitetin rajonal në bazë të marrëdhënieve të mira fqinjësore; një Kosove që është e angazhuar për sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore dhe fetare.

Neni 3
Mandati

Në mënyrë që të arrihen objektivat e politikës së BE-së në Kosovë, mandati i EUSR do të jetë:

- (a) të ofrojë këshillimin e BE-së dhe të mbështesë procesin politik;
- (b) të promovojë koordinimin e përgjithshëm politik të BE-së në Kosovë;
- (c) t'i ofrojë udhëheqje politike lokale Drejtuesit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), duke përfshirë në aspektin politik të çështjeve që lidhen me përgjegjësitë ekzekutive;
- (d) të sigurojë përputhshmëri dhe koherencë në veprimet e BE-së drejtuar publikut. Zëdhënësi i EUSR do të jetë personi kryesor kontaktues i BE-së për mediat në Kosovë rreth çështjeve të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë/Politikës Evropiane për Mbrojtje dhe Siguri. Të gjitha aktivitetet e shtypit dhe informimit të publikut do të kryhen në koordinim të afërt dhe të vazhduar me zëdhënësin e Sekretarit të Përgjithshëm/Përfaqësuesit të Lartë/Zyrën e Shtypit të Sekretariatit të Këshillit;

- (e) deri në skadimin e Vendimit të Përbashkët të Këshillit 2006/623/CFSP të datës 15 Shtator 2006 për themelimin e një ekipi të BE-së që kontibuon në përgatitjet për themelimin e misionit të mundshëm ndërkombëtar civil në Kosovë, duke përfshirë komponentin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (Ekipi Përgatitor i ICM/EUSR)¹, do t'i ofrojë udhëheqje politike dhe drejtim operacional Drejtuesit të Ekipit Përgatitor të themeluar në atë mënyrë, në përgatitje për kontributin e BE-së për Zyrën Ndërkombëtare Civile;
- (e) të kontribuojë në zhvillimin dhe konsolidimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kosovë, duke përfshirë ato që iu përkasin grave dhe fëmijëve, në pajtueshmëri me politikën e të drejtave të njeriut të BE-së dhe direktivat e BE-së mbi të Drejtat e Njeriut.

¹ OJ L 253, 16.9.2006, fq. 29. Vendimi i Përbashkët i amenduar së fundmi nga Vendimi i Përbashkët 2007/744/CFSP, OJ L 301, 20.11.2007, fq. 27.

Neni 4
Implementimi i mandatit

1. EUSR do të jetë përgjegjës për implementimin e mandatit duke vepruar nën autoritetin dhe drejtimin operacional të Sekretarit të Përgjithshëm/Përfaqësuesit të Lartë (SG/HR)
2. Komisioni i Politikës dhe Sigurisë (PSC) do të mbajë lidhje të privilegjuar me EUSR dhe do të jetë pika kryesore kontaktuese me Këshillin. PSC do t'i ofrojë EUSR udhëheqjen strategjike dhe drejtimin politik brenda kuadrit të mandatit.
3. Deri në skadimin e Vendimit të Përbashkët 2006/623/CFSP, EUSR do të përkrahët nga Ekipi Përgatitor i themeluar për këtë.

Neni 5
Financimi

1. Shuma e referuar e financimit për të mbuluar shpenzimet e lidhura me mandatin e EUSR në periudhën nga data e miratimit të këtij Vendimi të Përbashkët deri më 28 shkurt 2009 do të jetë 380 000 Euro.
2. Shpenzimet e financuara nga shuma e përcaktuar në paragrafin 1 do të jenë të mundura që nga data e miratimit të këtij Vendimi të Përbashkët. Shpenzimet do të menaxhohen më pajtim me procedurat dhe rregullat e aplikueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Evropiane me përjashtim që çdo para-financim nuk do të mbetet pronë e Komunitetit. Shtetasit e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor do të lejohen të tenderojnë për kontrata.
3. Menaxhimi i shpenzimeve do t'i nënshtrohet kontratës mes EUSR dhe Komisionit. EUSR do të mbajë përgjegjësi/**japë llogari** para Komisionit për të gjitha shpenzimet.

Neni 6
Krijimi dhe përbërja e ekipit

1. Një personel i dedikuar i BE-së do të emërohet për ta ndihmuar EUSR që të implementojë mandatin e tij dhe të kontribuojë në koherencën, dukshmërinë/**largpamësinë** dhe

efikasitetin e veprimit të përgjithshëm të BE-së në Kosovë. Brenda kufijve të mandatit të tij dhe mjeteve përkatëse financiare të vëna në dispozicion, EUSR do të jetë përgjegjës për krijimin e ekipit të tij në këshillim me Presidencën, i ndihmuar nga SG/HR, dhe në bashkëpunim të plotë me Komisionin. Ekipi do të përfshijë ekspertizë mbi çështje politike specifike ashtu si kërkohet nga mandati. EUSR do ta informojë SG/HR, Presidencën dhe Komisionin rreth përbërjes së ekipit të tij.

2. Shtetet anëtare dhe Institucionet e Bashkimit Evropian mund të propozojnë dërgimin e personelit që do të punojë me EUSR. Rrogat e personelit të dërguar nga një Shtet Anëtar ose një institucion i Bashkimit Evropian tek EUSR do të mbulohen përkatësisht nga Shteti Anëtar ose institucioni i Bashkimit Evropian në fjalë. Ekspertët e dërguar nga Shtetet Anëtare në Sekretariatit e Përgjithshëm të Këshillit gjithashtu mund të dërgohen tek EUSR. Personeli ndërkombëtar i kontraktuar duhet të ketë shtetësinë e një Shteti Anëtar të BE-së.
3. I gjithë personeli i dërguar do të mbetet nën autoritetin administrativ të Shtetit Anëtar dërgues apo institucionit dërgues të BE-së dhe do të kryejë detyrat e do të veprojë në interes të misionit të EUSR.

Neni 7
Privilegjet dhe imunitetet
e EUSR dhe personelit të tij

Privilegjet, imunitetet dhe garancitë e tjera të nevojshme për kryerjen dhe funksionimin e qetë të misionit të EUSR dhe pjesëtarëve të personelit të tij do të dakordohen si duhet. Shtetet Anëtare dhe Komisioni do të japin gjithë përkrahjen e nevojshme për një efekt të tillë.

Neni 8
Siguria e informacionit të klasifikuar

1. EUSR dhe pjesëtarët e ekipit të tij do të respektojnë parimet e sigurisë dhe standardet minimale të vendosura nga Vendimi i Këshillit 2001/264/EC i datës 19 Mars 2001 që miraton Rregulloret e Sigurisë së Këshillit¹, në veçanti për menaxhimin e informacionit të klasifikuar të BE-së.
2. SG/HR do të autorizohet të nxjerrë informacion dhe dokumente të klasifikuara të BE-së për NATO/KFOR deri në nivelin "CONFIDENTIEL UE" të gjeneruara për qëllime veprimi në pajtueshmëri me rregulloret e sigurisë së Këshillit.
3. SG/HR do të autorizohet të nxjerrë informacion dhe dokumente të klasifikuara të BE-së për OKB dhe OSBE, në pajtim me nevojat operacionale të EUSR deri në nivelin "RESTREINT UE", të cilat gjenerohen për qëllime veprimi në pajtueshmëri me rregulloret e sigurisë së Këshillit. Do të hartohen aranzhime lokale për këtë qëllim.

¹ OJ L 101, 11.4.2001, fq. 1. Vendimi i amenduar së fundmi nga Vendimi 2007/438/EC (OJ L 164, 26.6.2007, fq. 24).

4. SG/HR do të autorizohet të nxjerrë dokumente të paklasifikuara të BE-së të lidhura me diskutimet e Këshillit për palët e treta që kanë lidhje me këtë Vendim të Përbashkët, duke pasur parasysh veprimet e mbuluara nga detyrimi i fshehtësisë profesionale në pajtim me Nenin 6(1) të Rregullores së Punës së Këshillit¹.

Neni 9

Qasja në informacion dhe përkrahje logjistike

1. Shtetet Anëtare, Komisioni dhe Sekretariati i Këshillit do të sigurojnë që EUSR të ketë qasje në çdo informacion relevant.
2. Presidenca, Komisioni dhe/ose Shtetet Anëtare, kur duhet, do të japin përkrahje logjistike në rajon.

Neni 10

Siguria

Në pajtueshmëri me politikën e BE-së për sigurinë e personelit të punësuar jashtë BE-së në kapacitetin operacional nën Titullin V të Traktatit, EUSR do të marrë të gjitha masat e arsyeshme praktike, në përputhje me mandatin e tij dhe situatën e sigurisë në zonën e tij gjeografike të përgjegjësisë, për sigurinë e të gjithë personelit që është nën autoritetin e tij të drejtpërdrejtë, kryesisht nëpërmjet:

¹ Vendimi 2006/683/EC, Euratom i datës 15 Shtator 2006 që miraton Rregulloren e Punës së Këshillit (OJ L 285, 16.10.2006, fq. 47). Vendimi i amenduar së fundmi nga Vendimi 2007/881/EC (OJ L 346, 29.12.2007, fq. 17).

- (a) vendosjes së planit të sigurisë që është specifik për misionin bazuar në udhëzimet e Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit, duke përfshirë masat fizike, organizative dhe procedurale të sigurisë specifike për misionin, që do të drejtojnë menaxhimin e lëvizjes së sigurt të personelit në dhe brenda zonës së misionit si dhe menaxhimin e incidenteve të sigurisë duke përfshirë një plan emergjence dhe evakuimi të misionit;
- (b) sigurimit që i gjithë personeli i punësuar jashtë BE-së mbulohet me sigurim të rrezikut të lartë për jetën ashtu si e kërkojnë kushtet në zonën e misionit;
- (c) sigurimit se të gjithë pjesëtarët e ekipit të tij të punësuar jashtë BE-së, duke përfshirë personelin lokal të kontraktuar, trajnohen si duhet rreth sigurisë para ose sapo të mbërrijnë në zonën e misionit, bazuar në shkallën e rrezikut të përcaktuar për zonën e misionit nga Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit;
- (d) sigurimit se implementohen të gjitha rekomandimet e dakorduara pas vlerësimeve të rregullta të sigurisë, dhe paraqitjes së raporteve me shkrim për SG/HR, Këshillin dhe Komisionin mbi implementimin e tyre dhe mbi çështjet e tjera të sigurisë brenda kornizës së raporteve afat-mesme dhe të implementimit të mandatit.

Neni 11

Raportimi

EUSR në mënyrë të rregullt do të paraqesë raporte më gojë dhe me shkrim për SG/HR dhe PSC. EUSR gjithashtu do të raportojë në grupet punuese sipas nevojës. Raportet e rregullta me shkrim do të qarkullohen nëpërmjet rrjetit COREU. Me rekomandimin e SG/HR apo PSC, EUSR mund t'i paraqesë raporte edhe Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme dhe Marrëdhënieve të Jashtme.

Neni 12
Koordinimi

1. EUSR do të promovojë koordinimin e përgjithshëm politik të BE-së. Ai do të ndihmojë për të siguruar se të gjitha instrumentet e BE-së në terren angazhohen në mënyre koherente për të realizuar objektivat e politikës së BE-së. Aktivitetet e EUSR do të koordinohen kur duhet me ato të Presidencës dhe Komisionit, si dhe me Përfaqësuesit e tjerë Specialë të Bashkimit Evropian në rajon. EUSR do t'iu ofrojë njoftime të rregullta misioneve të Shteteve Anëtare dhe delegacioneve të Komisionit.
2. Në terren, do të mbahet ndërlidhje e veçantë me Presidencën, Komisionin dhe Drejtuesit e Misioneve të Shteteve Anëtare, të cilët do të bëjnë përpjekjet maksimale për të ndihmuar EUSR në implementimin e mandatit. EUSR do t'iu ofrojë udhëheqje politike lokale Drejtuesit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX KOSOVO), duke përfshirë edhe në aspektet politike të çështjeve që janë të bëjnë me përgjegjësi të ekzekutive. EUSR dhe Komandanti Civil i Operativës do të këshillohen me njëri-tjetrin sipas kërkesave.
3. EUSR gjithashtu do të ndërlidhet me organet relevante lokale dhe aktorët e tjerë ndërkombëtarë dhe rajonalë në terren.
4. EUSR, me aktorët e tjerë të BE-së që janë të pranishëm në terren, do të sigurojë përhapjen dhe ndarjen e informacionit mes aktorëve të BE-së në skenë, me synim arritjen e një shkallë të lartë të vetëdijesimit dhe vlerësimit të përbashkët rreth situatës.

Neni 13
Shqyrtimi

Implementimi i këtij Vendimi të Përbashkët dhe përputhshmëria e tij me kontributet e tjera të BE-së në rajon do të mbahet nën shqyrtim të rregullt. EUSR do t'i paraqesë SG/HR, Këshillit dhe Komisionit një raport progresi para fundit të qershorit 2008 dhe një raport gjithëpërfshirës të implementimit të mandatit nga mesi i nëntorit 2008. Këto raporte do të formojnë bazën për vlerësimin e këtij Vendimi të Përbashkët në grupet relevante punuese dhe nga PSC. Në kontekstin e prioriteteve të përgjithshme për vendosjen e misionit, SG/HR do t'i japë rekomandime PSC në lidhje me vendimin e Këshillit për rinovim, ndryshim apo ndërprerje të mandatit.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky Vendim i Përbashkët do të hyjë në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Neni 15
Publikimi

Ky Vendim i Përbashkët do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian

Përgatitur në Bruksel,

Për Këshillin
Presidenti
